VENDIM
Nr. 409, datë 13.5.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR. ARB/14/26, "ALBANIABEG AMBIENT SHPK, M. ANGELO NOVELLI DHE COSTRUZIONI SRL KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t'i shtohet fondi 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarë për të përballuar shpenzimet administrative për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/14/26, "Albaniabeg Ambient sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë", që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID).
2. Fondi prej 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarësh, i konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, t'i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.
3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës së buxhetit të shtetit.
4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama